




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.10.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. ~~Afrim Dina~~ ~~Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:~~

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar ~~Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi,~~ ~~nenkryetar i Komunës z. Fatmir Iska,~~ të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave, te OSBE-së dhe ju gjithë të pranishëm!  
Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:



**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën janar – shtator 2021,
4. Informatë për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021.

Fillimisht e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

A ka dikush diçka sa i përket procesverbalit.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për ju kryesues dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kisha një ndërhyrje ne faqe 7 që besoj që është gabim teknik dhe e ka humbur kuptimin fjalia që unë e kisha në fjalimin tim. Pra, fjala është për pikën rreth buxhetimit për vitin 2022, ku në rreshtin e 8-të thotë që në kuadër të investimeve kapitale kemi shpenzime dhe duhet të jetë kemi shpenzime për shërbime dhe mallra pasi ashtu po e humb kuptimin plotësisht kjo, kështu që sekretaria e kuvendit duhet ta bëj këtë përmirësim.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dyte te rendit te ditës.

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.**

**Shqipe Kryeziu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Pyetja ime i adresohet drejtorit te arsimit mirëpo e shoh që nuk është prezent, kështu që i drejtohem kryetarit te komunës. Pra, kemi informacion se kërkesat e shkollave për sigurimin e druve janë bërë që nga muaji qershor, atëherë pse nuk janë siguruar drutë për shkolla kur dihet se nga data 1 nëntor edhe zyrtarisht fillon periudha për ngrohje. Atëherë pse kjo neglizhencë ndaj institucioneve arsimore dhe kur do te filloni me shpërndarjen e drunjve neper shkolla.

**Mirjeta Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, drejtorët e drejtorive, kolege këshilltarë dhe gjithë te pranishmit. Pyetja ime ka të bëj me lëshimin e çerdheve ne funksion për këto që janë gati tani si Ratkoc, Krushë dhe Xërxe dhe a ka mundësi që te filloj me mësueset edukatore që janë me gjysmë norme dhe që janë në liste të pagave dhe pedagoget psikologe që i kemi futur nga organizata Caritas. Pastaj pyetja

tjetër është se çka do të bëhet me objektin e ish-postes ne Ratkoc, a do te ndërmerret diçka ne këtë drejtim, a do te largohet ai objekt dhe krijohet parking për çerdhen dhe ambulanten apo cilat janë masat që do të merrni rreth atij objekti.

**Florida Bajraktari** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Unë desha me pyet kryetarin, pasi ne fshatin Brestoc tek lagja e Diturisë, ka filluar rregullimi i shtratit te përroskës mirëpo vetëm dy ura janë përfunduar që janë betonuar dhe një pjesë e vogël është shtruar me beton, pra ajo kompani aty që po punon ka deklaruar se vetëm për atë pjesë janë obliguar të shtrojnë pasi me tepër nuk kemi para pasi komuna nuk e ka lëshuar pjesën tjetër. Kështu që dëshiroj me dit se si qëndron puna rreth kësaj, a do te mbetet ashtu apo do te vazhdohet më tutje pasi vërtet ka mbetur shume keq ashtu.

**Kryetari** – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit z. Afrim Dina, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues te mediave, OSBE-së, shoqërisë civile dhe gjithë te pranishmit ne sallë. I dëgjova me vëmendje pyetjet e e parashtruara. Sa i përket furnizimit me dru, procedurat e prokurimit kanë qenë te ngadalësuar për shkak te ankesave dhe është mirë që është lidhur kontrata dhe ka fillua furnizimi me dru neper shkolla. Sigurisht ne e kuptojmë shqetësimin pasi është me vend por nuk mund te dalim jasht procedurave kur ka ankesë, pasi është vonuar me shume se një muaj për shkak se nuk ka pasur OSHP-ja por tash është lidhur kontrata dhe ka fillua furnizimi para 3 dite dhe sigurisht se ky proces i furnizimit me dru neper shkolla do te mbyllet shume shpejt, ndoshta edhe ta lusë operatorin që me furnizua edhe gjate vikendit që me përfundua sa me shpejt këtë punë. Në pyetjen e parashtruar nga Mirjeta Krasniqi sa i përket objekteve ne qendër te fshatit Ratkoc, sigurisht që do te rrenohet ku është objekti ekzistues ku janë posta edhe zyrat e gjendjes civile dhe do te krijohet një park aty dhe gjithashtu edhe objekti i ish postes do te shohim procedurën pasi komuna e Rahovecit e ka dhanë ne shfrytëzim postes për me shume se 10 vjet që e e ka dhanë ne shfrytëzim dhe se çfarë do te ndodhë dhe me sigurinë me te madhe duhet me bo përpjekje që me lirua pasi ka disa pajisje që janë te ndjeshme dhe sigurisht ato do te largohen nga ana e Postes dhe Telekomit te Kosovës . Pra ne do te kërkojmë që me lirue atë vend si nevojë që me i krijua hapësirë me te mirë çerdhes për fëmijë. Gjithashtu pyetja juaj rreth funksionalizimit te çerdheve, ne kemi 3 çerdhe ne prag te përrimit ne Krushe, Xerxe dhe Ratkoc. Pra sfidë e madhe është funksionalizimi apo përfshirja e personelit te nevojshëm për te ofruar shërbime dhe për ti kryer punët që duhet me u krye ne çerdhe. Ju e dini se kuotet nuk na lejojnë ministria e financave me i ndryshua pasi nuk mund te kemi me shume mësimdhënës se sa që janë te përcaktuar me kuotën se sa mësimdhënës duhet te ketë komuna jonë, por ata që kanë gjysmë norme e sidomos edukatoret do ti përfshimë menjëherë dhe do te shohim mundësi dhe modalitete ku ka nevojë te hapen konkurse ne ndonjë shkolle fillore aty afër dhe atëherë te hapim konkursin për me u pranua ne shkolle dhe me pastaj te dërgohen ne çerdhe. Pra ne jemi te interesuar shume shpejt me i funksionalizuar dhe sigurisht se kemi shume sfida rreth kësaj pasi ne njëherë anë ne jemi për me hap çerdhe mirpo ne te njëjtën kohë nuk po te lejojnë me rrit numrin e punonjësve, por ne besoj që kemi zgjidhje edhe pse zgjidhjet mund te mos jen te plota ne fillim por pak me vone besoj që do te kompletohen ,pasi ngjashëm e kemi pasur edhe me çerdhen këtu ne qytet ku kemi bo bartje d.m.th i njëjti personel ka vazhduar punën por kemi bo edhe disa veprime që tash është me mirë personeli pasi është me i mjaftueshëm siç ka qenë ne fillim dhe besoj se kështu do te veprohet edhe ne 3 çerdhet e reja. Pastaj ne pyetjen e parashtruar nga Florida Bajraktari për një përrua që po trajtohet ne nje lagje ne fshatin Brestoc, që është një projekt i fituar nga IOM-i dhe i kontraktuar, ku projekti parasheh te bëhen disa veprime te cilat besoj që e zgjidhin problemin e ujërave te zeza edhe probleme tjera te cilat ju i dini por edhe ne do te ndërhyjmë si komunë pasi kam qenë disa herë ne vendin e ngjarjes, me shërbimet publike që ti trajtojmë edhe disa situata që nuk i kanë paraparë ne kontratë. Ne jemi marrë vesh me operatorin dhe si komunë do ta bëjmë punën tonë dhe që njëherë e mirë te zgjidhet ai problem qofshin ato ura, kolektorë dhe gjithçka që është mangu do ta rregullojmë. Pra drejtori i Shërbimeve publike është dakorduar

me operatorin dhe IOM-in, ndoshta për momentin mund të mos ketë para të mjaftueshme nga ana e tyre por sidoqoftë projekti ka me përfunduar mirë dhe do të jetë i qëndrueshëm dhe sigurisht se do të hiqet shqetësimi që ka qenë i madhe pasi kam qenë në vendin e ngjarjes dhe vërtet ka qenë preokupim i madhe i lagjes aty.

**Rukije Krasniqi** – Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë. Desha ta bëjë një pyetje rreth vendosjes së tabelave të cilat kanë të bëjnë lidhur me shqyrtimin e ankesave pasi kemi qenë anëtarë e komisionit të ankesave, a kanë filluar të vendosen tabelat sipas ankesave që janë marrë sipas vendimit pasi ende nuk vendosje të tabelleve rreth emërimit të rrugëve dhe shesheve urbane të ankesave të komisionit.

**Kryetari** – Nuk besoj që komisioni apo komuna ka pasur mundësi që me i plotësua ato kërkesa mirëpo pak a shume kemi vendos edhe kanë kërkuar me i vendos tabelat, pasi puna e komisionit në mandatin e kaluar dhe komisionit ekzistues nuk mund të themi që është krye apo është kompletuar ky projekt pasi që shume vende nuk ka tabela ende, e sidomos ka fshatra që nuk ka asnjë lloje tabelle. Sigurisht se është gabim pasi në këtë mandat edhe nuk kemi pasur kontratë por sa është menduar për këtë temë duhet të kemi një lloje sigurie kur i vendosim tabelat. Në disa pjesë të komunës kanë zënë vend dhe nuk ka pasur asnjë lloj telashe mirëpo në disa pjesë janë hequr nga elementë të caktuar që nuk janë pajtuar me ato emërtime dhe unë e kam ndjekur njëfarë strategjie të stabilitetit dhe po besoj që duhet të vendosen ato tabela për shkak se ka ardhur koha me u vendos për të gjitha ato emërtime që ka vendos kuvendi i komunës edhe gjithashtu për këtë mandat që ka vendos kuvendi i komunës duhet të vendosen tabelat në përputhje me tri vendimet e kuvendit të komunës së Rahovecit si 2014, 2015 dhe 2021. Pra këto tri vendime kërkojnë zbatim në praktik dhe në do të kujdesemi për shkak se nuk është mirë me qitë një emër dëshmorë apo një emër të respektuar edhe mos me pranua në atë lagje edhe pse diku kanë gjetur vend dhe janë stabilizue mirëpo diku tjetër kemi pasur telashe edhe pse janë vendos ato janë largue nga aty. Por jam dakord që duhet të zbatohet plotësisht vendimet e kuvendit të komunës sa i takon këtyre situatave edhe pse ka pakënaqësi edhe pse ju e dini që në nuk mund ti ndërrojmë dhe të bëjmë ndryshime në vendime pa kalua një periudhë e caktuar dhe ky problem në të gjitha komunat mirëpo ato që I kemi me vendime duhet ti respektojmë dhe ti zbatojmë. Në nuk kemi pasur kontratë dhe kemi vepruar në bazë të kërkesave të një familje apo lagjeje apo kryesia e fshatit ka ardh me kërkesë që rruga e caktuar nuk ka tabelle dhe në e kemi vendos edhe pse kemi shume raste kështu por nuk mund të themi se janë zbatue vendimet e kuvendit të komunës së Rahovecit.

**Refki Kryeziu** – Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët asamblistë dhe gjithë të pranishmit. Në shkollën fillore “Hamëz Thaqi”, në Xerxe në hyrje të shkollës në terracë kishte ndodh një plasaritje e madhe e betonit dhe do të ishte mirë të ndërmerret ndonjë masë që mos me ndodh ndonjë fatkeqësi që me u lëndua ndonjë nxënës, pasi në e dimë që ju e keni paraparë si projekt ndërtimi i shkollës fillore në Xerxe por derisa ajo të ndodhe do të ishte mirë të merren masa për renovimin e asaj plasaritje të betonit aty që të mos kemi ndonjë fatkeqësi që të mos dëmtohet ndonjë nxënës.

**Kryetari** – Faleminderit për pyetjen, me vjen keq që nuk e kam këtë informatë por sidoqoftë informatën që e kam unë është se ka fillua efënca dhe kjo nuk do të thotë që ka me pengua ndërtimin e ri të shkollës aty por as në Bekim Sylka por as në aneksin e Ratkoc por as në shkollën fillore në Pastasel. Në po bëjmë përpjekje që me u përfshije në sistemin nga ministria e arsimit që me qenë projekte të tyre por duhet me i marr përsipër angazhimet tona. Por për informatën tuaj, sigurisht që në momentin e parë do të kujdesem që me bisedue me drejtorin e arsimit që me pae se a kemi mundësi me intervenua sa me shpejt.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume kryetar, atëherë kolegë të nderuar meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

### 3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.

**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, kryetar, kuvendarë dhe gjithë ju te pranishëm. Raporti financiar 9 mujor ne periudhën Janar – Shtator 2021 është i përberë nga 3 pjesë, si pjesa e te hyrave, pjesa e shpenzimit te buxhetit dhe pjesa e prokurimit që kemi ne raport per kontrata e lidhura deri ne shtator te këtij viti. Të hyrat ne këtë periudhë ku ne total te hyrat e rregullta janë 923,391 euro dhe nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njejtë te vitit te kaluar atëherë kemi një ndryshim pozitiv ne vlerë prej 121,249 euro, ndërsa bashk me gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut te cilat ne total janë 1,5513 ku ne raport me periudhën e njejtë te vitit te kaluar është një ndryshi pozitiv ne vlerë prej 61,566 euro. Sa për dijeninë tuaj deri me kete periudhe nuk kemi pasur një raport sa i përket gjobave nga gjykatat dhe trafikut ne 3 mujorin e parë si dhe 3 mujorin e dytë. Gjithashtu për informimin tuaj do te ju jap një informatë, dje kanë arritur gjobat nga gjykatat dhe trafiku për dy periudha pra ne 3 mujorin e parë dhe te dytë dhe këto ne total janë prej 152,813 euro që bashke me këto te hyra deri ne ditën e sodit i kemi ne shumen prej 1,241,487 që do te thotë kemi tejkalim te planit ne vlerë prej 180,394 euro. Tek realizimi i buxhetit, i kemi ne faqe 6 edhe te hyrat nga tatimi ne pronë që kanë një ndryshim pozitiv nga periudha e njejtë e vitit te kaluar prej 183,000 euro ndërsa te realizimi i buxhetit ne këtë periudhe është i shpenzuar ne vlerë prej 10,944,151 euro duke përfshirë te gjitha programet dhe kategoritë ekonomike që shprehur ne përqindje janë 70,62% ne total ndërsa pagat dhe mëditjet janë te shpenzuara 73,64%, mallra dhe shërbime 62,60%, shpenzimet komunal 67,60%, subvencionet 88,08% dhe shpenzimet kapitale 67,69% që ne total përbejnë një vlerë prej 70,62%. Pastaj ne pjesën tjetër te raportit kemi te prezantuar kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ne menyre analitike ne kuadër te kodeve ekonomike, gjithashtu i kemi te prezantuara edhe shpenzimet komunal si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njejt te vitit te kaluar dhe krejt ne fund kemi një raport te detajuar te zyrës se prokurimit te gjitha kontratat që janë te lidhura deri ne këtë datë, pra 30 shtator te këtij viti.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht e falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për periudhën janar – shtator të këtij viti në komunën e Rahovecit. Tek te hyrat vetanake po shihet që karshi planifikimit është bërë një realizim më i madh që është diçka e mirë dhe shkon në interesin e qytetarëve. Edhe te krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore gjithashtu është një progres, po ashtu e përmendi edhe drejtori se gjobat e gjykatave dhe te trafikut nuk janë te paraqiture të gjitha te dhënat, po ashtu shihet te gjobat e gjykatave se ka pak rritje përkundër asaj që mungojnë te dhënat tjera. Pastaj ne faqe 5, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike, nga ajo që kam analizue me tepër te kemi si formë te pyetje për drejtorin që krahasuar me planifikimin për vitin 2021, ne disa kode kemi raste se kemi realizim shume me te madhe ne vitin 2021 karshi planifikimit që ka qenë dhe gjithashtu kemi rënie ne disa kode si te taksat për legalizim te objekteve ku ne planifikim për vitin 2021 ka qenë e paraparë 28,000 euro kurse realizimi është mbi 9000 euro. Gjithashtu edhe te participimet ne bujqësi planifikimet kanë qenë i madhe 80,000 euro kurse realizimi është 43,766 euro. Te faqe 6, te tatimi në pronë shihet që kemi rritje të hyrave nga tatimi në pronë dhe për këtë e përgëzoj drejtorin që ka arritur me rrit rritjen e tatimit ne pronë. Te shpenzimet sipas kategorive ekonomike, që edhe në KPF e kam thënë përkundër asaj që tha drejtori se është bërë realizimi ose shpenzimi i buxhetit, mirëpo unë mendoj që konkretisht te shpenzimet kapitale e kemi me përqindje 67,69% dhe nëse shkojmë ne mënyrë proporcionale do te ishte mirë 85% edhe pse nuk dyshoj ne realizim te buxhetit sepse komuna e Rahovecit njihet vazhdimisht pasi asnjëherë nuk ka pasur probleme pasi çdo herë është shpenzuar mbi 98% do vit dhe besoj që edhe këtë vit besoj që do të realizohet mirëpo për momentin kjo është gjendja e tanishme. Pastaj nëse dalim te shpenzimet mallra dhe shërbime sipas programeve ne mënyrë analitike siç e tha edhe drejtori, te kodi 13020 mirëmbajtja e ndërtesave, që e shoh te kuvendi komunal janë harxhuar 5000 euro dhe vetëm desha një sqarim se ku është bërë ky shpenzim, pastaj kemi te shëndetësia dhe mirëqenia sociale një shpenzim me te

madhe dhe sigurisht se ka ndikuar edhe pandemia që ka qenë dhe gjithashtu edhe ne arsim kemi pasi ka qenë 148,000 kurse tash kemi 178,000 pra një shpenzim më i madh, kështu që edhe për shumë sqarime tjera sigurisht edhe koleget tjera kanë për te diskutuar, pastaj ne faqe 14, te shërbimet komunale që edhe këtu shihet se kemi rritje të shpenzimeve edhe në rrymë, në ujë, në mbeturina, po besoj që drejtori do të na jep sqarime rreth këtyre ndërsa te aktivitetet e prokurimit desha me pyet që te gjitha projektet që janë duke u realizuar edhe ato që janë realizuar edhe këto që janë ne realizim e sipër si është duke shkuar dinamika e punimeve dhe do te doja te marr një përgjigje rreth kësaj.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, fillimisht përshëndes drejtorin e drejtorisë për financa z. Afrim Limani lidhur me përgatitjen e këtij raporti financiar janar – shtator 2021. Raporti është i qartë pasi i ka te gjitha elementet duke përfshirë edhe krahasimet me vitin paraprak dhe ashtu siç e tha edhe parafolësi, që ne fakt ne e kemi shqyrtuar këtë raport edhe ne komitet për politike dhe financa dhe mendojmë se nuk kemi nevojë me i përsërit ato që i kemi diskutuar. Ajo që bie ne sy të hyrat në raport me vitin paraprak që është një bilanc pozitiv pastaj edhe me planifikimin që është gjithashtu është bilanci pozitiv dhe ne i gëzohemi faktit që ka më shumë buxhet dhe është interesi i qytetareve, gjithashtu edhe kjo pjesa e të hyrave te tatimit ne prone ka shënuar te hyra me te mira krahasuar me vitin te kaluar me periudhën njëjtë, mirëpo, kur jemi me të hyrat më shumë në krahasim me vitin e kaluar ne e kemi cekur edhe më përpara janë dy elemente që i kemi marr parasysht, pasi viti i kaluar ka qenë vit i pandemisë që ka pasur izolime dhe karantinime dhe sigurisht është pritur që të hyrat të jenë më të vogla pastaj edhe planifikimi i buxhetit që e kemi cekur edhe me përpara ka qenë i ulët dhe nuk ka qenë bash ashtu i arsyeshëm apo racional karshi te hyrave që i ka komuna jonë prandaj edhe ajo që është planifikuar për buxhetin për vitin 2022 ku ne kemi dhënë kontributin tonë është një buxhet pakës me i arsyeshëm por sidoqoftë te hyrat janë më të mira. Tek faqe 5, tek planifikimi edhe këtu është një çështje që ne e kemi përsëritur edhe ne te kaluarën drejtoritë duhet te jenë më të kujdesshme në planifikimin e të hyrave sepse kur analizohet më vonë tek raporti, planifikimi i të hyrave me realizimin shumë kode kanë diskrepancë të madhe, pasi nëse drejtoritë janë me të arsyeshme dhe me preciz në planifikim atëherë këto diskrepanca nuk do të jenë kaq të mëdha p.sh. taksa rrugore planifikimi ka qenë 85,000 euro kurse te hyrat deri ne këtë periudhe për 9 muaj janë 250,000, pra kjo është ajo që po e them dhe kjo duhet të përmirësohet në të ardhmen. Po ashtu një ndërhyrje tjetër që duhet me bo është te prokurimi pasi kam kërkuar sqarimin edhe ne mbledhje te komitetit për politikë dhe financa dhe ajo që bie ne sy është tek shërbimet konsulentë që është një numër shume i madhe i punëtorëve te punësuar ne shërbime konsulentë për drejtori te caktuara e sidomos drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, aty janë 7 punëtorë të punësuar për shërbime konsulentë. Pra, vetëm konsulentë individual për koordinim me OJQ-të janë dy pozita, kështu që mua më duket edhe ashtu numri është i madh prej 7 personave në një drejtori dhe nuk e di sa është numri i punëtorëve të kësaj drejtorie por si duket numri i konsulentëve e tejkalon numrin normal të punëtorëve dhe kjo nuk është ne rregull pasi nëse vërtet drejtoritë nuk kanë mjaftueshëm punëtor atëherë do të ishte më mirë që të punësohen dhe të jenë punëtorë të rregullt aty dhe te japin kontributin e tyre se sa te punësohen për një vit sa e kanë kontratën dhe gjithashtu është diskutabile nëse ata vërtet e kryejnë punën e tyre për atë që paguhen. Dhe gjithashtu shtrohet pyetja se a është vërtet e nevojshme një numër kaq i madhe i konsulentëve te punësuar në një kontratë te përkohshme brenda një viti apo dy vite. Kështu që nëse përpjesëtohen gjithsej 34 punëtorë mund te formoheshin disa drejtori të rregullta por sidomos te drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kisha kërkuar një sqarim se pse është një numër kaq i madh i konsulentëve pasi është e kushtueshme dhe ata njerëz paguhen dhe ne nuk e dimë se me te vërtet e kryejnë punën për këto para që po paguhen.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet, disa nga përgjigjet i kam dhënë edhe ne mbledhjen e KPF-së, ku asamblisti Rasim Fazliu e ka një krahasim apo dallim ne raport me planifikim dhe inkasim te te hyrave. Pra është shume e vërtet që ne disa kategori te te hyrave ka një dallim mirëpo krejt këto ndryshime ne masën me te

madhe ka ndikuar pandemia që e kemi pasur vitin e kaluar. Po ashtu pyetje tjetër ishte edhe dallimi në nën kodë të participimit në bujqësi dhe në kemi marrë si masë krahasuese realizimin e të hyrave në raport me vitin 2020 mirëpo në këtë vit nuk ka pasur thirrje në përgjithësi për thirrje të ndryshme dhe kjo me siguri ka ndikuar që ka një dallim në krahasim planifikim dhe realizim që në presim që brenda këtij viti të bëjmë edhe thirrje të tjera edhe sigurisht se do të bëhet edhe ndoshta do të realizohet planifikimi me realizimin. Po ashtu pyetje tjetër është edhe realizimi i buxhetit që është një trend i mirë dhe me përgjegjësi e them para juve që trendi i realizimit të buxhetit deri në këtë periudhë është duke shkuar në masë të madhe dhe deri me tani jemi përafërsisht 80% të buxhetit që besoj që deri në fund të vitit fiskal kjo përqindje të shkojë si zakonisht ashtu siç e keni thanë edhe ju që ka shkuar deri në 98%. Po ashtu një pyetje tjetër ishte të shpenzimi i buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime, të kategorisë mirëmbajtje e ndërtesave për një shpenzim në shumën prej 5000 eurove se ku janë shpenzuar këto. Pra këto shpenzime janë meremetimin e sallës së kuvendit dhe brenda vitit 2020 nuk kemi mundur ta bëjmë pasi meremetimin e ka bërë në fazën finale pas mbylljes së vitit fiskal dhe pjesën tjetër të borxhit e kemi paguar në këtë vit, që ndërlidhet kryesisht me mirëmbajtjen e kësaj sale të kuvendit. Pastaj shpenzimi i madhe dallimi në shpenzim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar të komunalit, pra edhe këtu ka ndikuar pandemia që e kemi pasur vitin e kaluar që ky shpenzim me shumë ndërlidhet me shkollat pasi me muaj të tërë nuk kanë funksionuar dhe deri sa nuk kanë funksionuar nuk ka pasur shpenzim si të rrymës ashtu edhe të ujit, që të njëjtin pyetje e bëri edhe doktori sa i përket të dallimi planifikimit dhe realizimit të buxheti që u ndërlidh të një kodë të taksa rrugore, që realisht edhe taksat rrugore në vitin e pandemisë nuk ka pasur aplikim për regjistrimin e makinave dhe kjo nuk ka ndikuar në ramje të madhe dhe ky është dallimi. Pastaj pyetjet tjetër ishte për shërbimet konsulente që këtë pyetje e keni parashtrua edhe në mbledhje të KPF-së të drejtorisë së kulturës rreth numrit të madhe, ndoshta këtë përgjigje me se miri do ta jep drejtoresha e Kulturës pasi tani nuk është prezent me siguri ta dreson me shkrim, pasi tenderin për shërbime konsulentë e kemi shpallur në bazë të kërkesave sipas drejtorive p.sh. drejtorisë së financave ka pasur nevojë për 4 punëtorë dhe tenderi u hap për 4 punëtorë dhe secila drejtori që i ka parashtrua sipas kërkesave të veta është shpallur edhe tenderi. Për këtë pyetje ndoshta arsyetimin me të mirë mund ta jap drejtoresha e kulturës për kërkesat që i ka brenda drejtorisë.

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë drejtor për të gjitha sqarimet, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

#### **4. Informatë për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021.**

**Bjondina Rama** – Përhëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, drejtorët, asamblistët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sa i përket informatës për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit për vitin 2021, gjendja është dukshme e rregulluar në vitin 2021 ku kemi para vetes edhe raportin, sigurisht se ka nevojë për përmirësime sepse ambienti është një mjedis që gjithmonë ka nevojë të përmirësojmë dhe të rregullojmë infrastrukturën e sidomos në çështjen e menaxhimit të mbeturinave. Komuna jonë ka përfituar vazhdimisht viteve me radhë e sidomos për grantin për mjedis të pastër si në vitin 2018 pastaj grantin në vitin 2011 pastaj në vitin 2019 dhe gjithashtu edhe për vitin 2020. Pra kemi përfituar vit pas viti dhe kemi përkrahjen e donatoreve që vlen të ceket me agjencionin japonez për bashkëpunim ndërkombëtar dhe vazhdimisht kemi bashkëpunime me projekt 3 vjeçar që është një vlerë shumë e madhe e sidomos për komunën tonë që është një projekt 3 vjeçar që është fazë për përmirësim dhe grumbullim duke filluar me infrastrukturë, përmirësimi i shërbimeve grumbullim i mbeturinave në komunë të Rahovecit, përmirësimi i burimeve financiare pastaj rritje e stafit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, përmirësimi rreth operimit dhe gjithë ky projekt do të përfshihet në vitin 2021-2024. Të gjithë e keni raportin para vetes dhe nëse keni ndonjë pyetje, unë do të jem këtu për të ju përgjigjur.

**Kryesuesi** – Faleminderit për sjelljen e këtij raporti, ne e kemi trajtuar edhe ne mbledhjen e KPF-së por gjithsesi ju falënderoj për kontributin tuaj që komuna jonë te jetë me një ambient sa me të mirë dhe të pastër.

**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues, unë mendoj se nuk është e mjaftueshme vetëm investimet por duhet te bëhet edhe lobimi për mirëmbajtjet dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor pasi që kjo është edhe shëndeti ynë. Pra duhet me tepër te punohet ne këtë drejtim rreth vetëdijesimit qytetar dhe te merret pak me tepër edhe me mësimdhënësit dhe shkollat për ndonjë aktivitet për mirëmbajtje për mjedise që është një lobim shume i mirë dhe i qëlluar dhe te mbetet një pasqyrë e mirë që kontributi qytetar është ne nivel jo vetëm investimi por edhe lobimi dhe vetëdijesimi qytetar është shume me rëndësi.

**Kryesuesi** – Faleminderit zonja Krasniqi për kontributin, te nderuar kolegë kuvendarë duke ju falënderuar te gjithëve për kontributin e dhënë, shihemi ne mbledhjen e radhës.

01 Nr.245/21

Rahovec:22.11.2021

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

